

RELACION TEKNIK

**OBJEKTI: SHKALLARE LIDHESE NGA RRUGA
“GJERGJ ARANITI “TEK RRUGA “LEFTER TALO”**

POROSITES : BASHKIA SARANDE



Saranda si shumë zona të tjera bregdetare si shtyllë të zhvillimit të tij ka sektorin e turizmit, ky sektor është pjesa kryesore e zhvillimit ekonomik të zonës, duke rritur në mënyrë të drejtpërdrejtë punësimin në ofrimin e shërbimeve por gjithashtu ka ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë së zonës, meqënëse 80% e produkteve ushqimore të ofruara përballohen nga tregu vendas.

Zona ku do të kryhet zhvillimi sipas PPV është zonë me kategori bazë shërbime . Ndërhyrja në territor do të bëhet sipas propozimeve të PPV, të cilat duhet të mbajnë në konsideratë përmirsimin dhe shtimin e infrastrukturave publike për nënjesinë.

Duke qene se qyteti i sarandes esht enje nga nyjet kryesore te turizmit ne Shqiperi , me rritjen e kerkeses dhe frekuentimit rritet dhe pergjegjesia per ti ofruar ketij tuzimit hapësira dhe shërbime. Nje nga nevojat qe ka lindur si pasoje e kesaje kerkese eshte krijimi i nje nyje lidhese midis dy rrugeve kryesore te ketij qytetit , konkretisht asaj “GJERGJ ARANITI” me rrugen “LEFTER TALO”. Te dyja keto rruge jane nyje kryesore te levizshmerise ne qytet , dhe krijimi i nyjes lidhese midis tyre do rriste ndjeshem permiresimin e saj. Per kete arsye jane menduar ndertimi i dy shkallarave preje guri ne segmentet e saj.



Shkallarja e pare

Kjo shkallare do te beje lidhjen e dy nivele te relievit , duke zbritur nga kuota 58.53 ne kuoten 47.50 , do te kete nje gjeresi rampe prej 3m , rampe kjo e cila do ndahet ne 6 pjese pergjate gjatesise se saj , secila me 10 kembshkalle duke e bere keshtu dhe komode ngjitjen dhe zbritjen e saj. Ne pjeset anesore te saj kjo rampe do te kete gjelberim te ulet dhe te mesem , i vendosur ne hapesiren prej 70 cm pergjate te dy aneve te saj , dhe gjithashtu e kufizuar me gjelberim te larte per te bere te mundur keshtu hijezimin e saj pergjate diteve te nxehta. Materiali i perdorur per shakllet do jet gur natyror me relief te ashper . Muri rrethues i rampes i cili do mbaje dhe gjelberimin do kete nje lartesi prej 65 cm , ne te cilin do vendosen dhe aplikat e ndricimit. Ne sheshpushimet e rampave do te kemi te vendosura vazo luli prej druri me gjelberim te mesem.



Shkallarja e dyte.

Kjo shkallare ben te mundur lidhje e rruges nga kuota 44.60 ne kuoten 25.52 . Duke pare disnivelein e madh qe na jep relievi si dhe distancen midis dy rrugeve eshte propozuar ndertimi i nje shkallare diagonale ne menyre qe te arrihet kuota e kerkuar ne distancen e mundesuar. Kjo shkallara perbehet nga 9 rampa , te vendosura paralelisht me njera tjetren , me nje gjeresi prej 3 m si dhe mur rethues perimetral 65 cm. Muri perimetra gjithashtu do te sherbeje per mbajtje gjelberimit e ulet dhe te mesem , kyesisht nje nga lulet simbol te Sarandes , ate te bugovileve , te cilat to te varen pergjate lartesis se murit midis dy rampave . Muri rrethues i rampes i cili do mbaje dhe gjelberimin do kete nje lartesi prej 65 cm , ne te cilin do vendosen dhe aplikat e ndricmit. Ne sheshpushimet e rampave do te kemi te vendosura vazo luli prerj druri me gjelberim te mesem. Materiali kryesor i perdorur per



shkallaret eshte guri natyral i skalitur.



jjk